



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

**KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES, RISHIKUES,
KORRIGJUES DHE RIKORRIGJUES TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE**

Njoftohen të gjithë të interesuarit për të aplikuar si hartues, hartues rishikues, korrigjues dhe rikorrigjues, për provimet e aftësive profesionale për sezonin 2026 në disiplinat si më poshtë vijon:

1. *“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare” – 19 Dhjetor 2026;*
2. *“Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë” - 16 Janar 2027;*
3. *“Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit Financiar” - 30 Janar 2027;*
4. *“Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit” - 20 Shkurt 2027;*
5. *“Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës” - 27 Shkurt 2027.*
6. *“Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit” - 6 Mars 2027;*

Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit dhe hartuesit rishikues janë si më poshtë:

Hartuesit dhe hartuesit rishikues duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Si dhe përvec pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë Sekretarisë Teknike pranë organizatës profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

Kriteret që duhet të plotësojnë korrigjuesit dhe rikorrigjuesit janë si më poshtë:

Korrigjuesit dhe ri korrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale sëbashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë Sekretarisë Teknike pranë organizatës profesionale IEKA *(një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike)*.

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Çdo kandidat që aplikon për hartues, hartues rishikues, korrigjues dhe rikorrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë Sekretarisë Teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:

- a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
- b. Curriculum Vitae;
- c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
- d. Fotokopje të diplomave;
- e. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

**Të gjithë kandidatët do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.*

Shënim*

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues, hartues rishikues, korrigjues dhe rikorrigjues për provimet e aftësive profesionale për titullin Kontabilist i Miratuar dhe Auditues Ligjor për sezonin 2026 fillon menjëherë nga njoftimi **më datë 11.09.2026** dhe përfundon më **datë 30.10.2026 ora 14:00**.